**KËRKESË**
**Nr. 384/6, datë 2.9.2022**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 769, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave 'Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza Lindore Tiranë, loti III (shtesa)''", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 45,651,432 (dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";
- për pasurinë "Objekt banimi", është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 45,651,432 (dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
**Egra Ibrahimi**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III (SHTESA)''''

| Nr. | PRONARI | | | TË DHËNA HIPOTEKORE | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | | | | | | | SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | "Arë" | | | "Truall" | | | "Ndërtesë" | | | Vlera totale (lekë) | |
| | **Emri** | **Atësia** | **Mbiemri** | **Fshati ose qyteti** | **Z. kadastrale** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pasurisë** | **Sipërfaqja totale** | **"Arë"** ($m^2$) | **"Truall"** ($m^2$) | **"Ndërtesë"** ($m^2$) | **Sipërfaqja** ($m^2$) | **Çmimi** (lekë/$m^2$) | **Vlera** (lekë) | **Sipërfaqja** ($m^2$) | **Çmimi** (lekë/$m^2$) | **Vlera** (lekë) | **Sipërfaqja** ($m^2$) | **Çmimi** (lekë/$m^2$) | **Vlera** (lekë) | | |
| | *A* | *B* | *C* | *C* | *Ç* | *D* | *E* | *F* | *G* | *H* | *I* | *L* | *M* | *N* | *O* | *P* | *Q* | | | | *Y* | *Z* |
| 1 | Vjollca | Hajdar | Alla | Tiranë | 3976 | 155/50 | Arë | 1180 | 1180 | | | 334 | 448 | 149,632 | | | | | | | 149,632 | Proces konfirmimi (plotësim dokumentacioni). |
| | Avni | Hajdar | Qosja | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Myzejen | Hajdar | Miccolis | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Alime | | Qosja | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Sadik | Murat | Luga | Tiranë | 8180 | 7/634 | Truall | 1500 | | 1500 | | | | | 1,340 | 31,270 | 41,901,800 | | | | 41,901,800 | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 3 | Adriana | Muharrem | Gega | Tiranë | 8170 | 8/523 | Truall | 520 | | 520 | 85 | | | | | | | 40 | 90,000 | 3,600,000 | 3,600,000 | Proces konfirmimi (plotësim dokumentacioni) Shpronësuar për truallin në VKM-në nr. 557, datë 27.5.2016. |
| | Donald | Bexhet | Gega | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | **Vlera totale** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 45,651,432 | |